



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2021:171940

Datë: 30.08.2024

Numri i dokumentit: 06105779

2021:180050

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM DIVIZIONI PENAL, gjyqtarin i vetëm gjykues Imri Sejda, me zyrtaren ligjore Kimete Bytyqi, në çështjen penale kundër të akuzuarit B.I. nga fsh. ..., duke vendosur lidhur me aprovimin e marrëveshjes së ndërmjetësimit me ND.nr..../24, të datës 27.08.2024, e lidhur në Qendrën e Ndërmjetësimit në Ferizaj në mes të akuzuarit në njërën anë dhe të dëmtuarit N.I. në anën tjetër, sipas aktakuzës së Prokuroria Themelore në Ferizaj PP/II.nr.1006/21 të datës 12.08.2021, për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.1 nën par. 1.4 të KPRK-së, në mbështetje të nenin 15 par.1 të Ligjit për Ndërmjetësim nr.06/L-009, më datën 30.08.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET marrëveshja ND.nr..../24, të datës 27.08.2024, e lidhur në Qendrën e Ndërmjetësimit në Ferizaj në mes të akuzuarit B.M.I. nga fsh.... K. Ferizaj, i lindur me dt. ..., me nr. personal ..., në njërën anë dhe të dëmtuarit N.F.I. nga fsh.... K Kaçanik, në anën tjetër.

Hudhet aktakuza e Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.1006/21, e datës 12.08.2021 dhe PUSHON procedura penale kundër të akuzuarit B.I., për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.1 nën par.1.4 të KPRK-së .

Shpenzimet e procedurës bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Ferizaj, me aktakuzën PP/II.nr.1006/21, të datës 12.08.2021, ka akuzuar të akuzuarin për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.1 nën par. 1.4 të KPRK-së, dhe ka kërkuar që i akuzuari të shpallet dhe të dënohet sipas ligjit.

Me dakordimin e palëve në shqyrtimin gjyqësor me dt.15.08.2024, konform nenit 229 të KPPRK-së dhe nenit 4 dhe 8 të Ligjit për ndërmjetësim, u vendos që lënda të dërgohet në Qendër për Ndërmjetësim.

Me datë 27.08.2024, në Qendrën e Ndërmjetësimit në Ferizaj është arritur marrëveshja ND.nr..../24, në mes palëve në procedurë.

Andaj Gjykata duke vepruar konform dispozitave të nenit 15 par.1 të ligjit për Ndërmjetësim e aprovoj këtë marrëveshje pasi që e njëjta u vlerësua se është lidhë me vullnetin e plotë të palëve për çështjen dhe është në pajtim me ligjin për ndërmjetësim në fuqi.

Konform nenit 15 par.1 të ligjit për Ndërmjetësim në datën 30.08.2024, aprovohet nga gjykata marrëveshja për ndërmjetësim dhe e njëjta do ta ketë fuqinë e titullit ekzekutiv.

Konform nenit 453 par.1 të KPK-së shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore.

Nga sa u tha më lartë, e konform nenit 248 par. 1 pika 1.4 të KPPK lidhur me nenin 15 par.1 të ligjit për Ndërmjetësim nr.06/L-009, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ,

2021:180050, me dt. 30.08.2024.

Zyrtare ligjore

Kimete Bytyqi

Gjyqtari i vetëm gjykues

Imri Sejda

KËSHILLA JURIDIKE: kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afat prej 3 /tre/ ditëve nga dita e pranimit të kopjes me shkrim të këtij aktvendimi, përmes kësaj gjykate.